

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 318, Datë 12.12.2025

MBI

**REFUZIMIN E LICENCIMIT TË SHOQËRISË “GET SOLAR SOLUTION” SH.P.K.
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 11, pika 2, 13, pika 2, germa “a”, si dhe 14, pika 2 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2499/9 prot., datë 10.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi refuzimin e licencimit të shoqërisë “GET Solar Solution” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “GET Solar Solution” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2499 prot., datë 23.09.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 24 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3164, fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 250, datë 08.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 10.10.2025 dhe 11.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.11.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2499/3 prot., datë 16.10.2025, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të

drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 2499/4 prot., datë 20.10.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht nga ky aplikim. Detyrimi për depozitimin e dokumentacionit sa më sipër, i është rikujtuar shoqërisë përsëri edhe me e-mailin e ERE-s të datës 2499/5 prot., datë 13.11.2025. Në vijim, me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2499/6 prot., datë 17.11.2025, shoqëria ka depozituar një argumentim teknik në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit, si dhe informacion dhe dokumentacion plotësues për aplikimin, nga analizimi i të cilit rezultoi se ishte ende i nevojshëm të plotësohej dokumentacioni/informacioni në lidhje me mbështetjen financiare si dhe në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit për të cilin i është dhënë miratimi në parim i OST-së dhe VNM-ja Paraprake.
- Me qëllim sqarimin e dokumentacionit të sipërcituar, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore, e cila iu njoftua shoqërisë nëpërmjet shkresës nr. 2499/8 prot., datë 19.11.2025 dhe e-mailit të të njëjtës ditë. Seanca dëgjimore u zhvillua në ambientet e ERE-s, në datën 25.11.2025. Pas sqarimeve të dhëna në këtë seancë në lidhje me sa mbetet ende pa plotësuar, nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë “GET Solar Solution” sh.p.k., u mor angazhimi për të plotësuar në vijim informacionin/dokumentacionin e munguar.
- Në vijim të sa më sipër nuk rezulton që nga ana e shoqërisë të jetë depozituar sa kërkuar (dokumentacion plotësues).

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Nga analizim i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar, rezulton se:
- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave a, b, c dhe d.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave a dhe c.
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave a, b, d dhe e.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka depozituar Kontratën nr. 3025 rep., nr. 1478 kol., datë 02.06.2025 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 24 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, zonën kadastrale nr. 3164, Fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë, nga shoqëria “GET SOLAR SOLUTIONS” sh.p.k.”, datë 02.06.2025, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe “GET Solar Solutions” sh.p.k.
- Shoqëria ka depozituar shkresën e OST sha të datës 03.04.2024, për miratimin në parim të pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit, me fuqi të instaluar prej 24 MWp (20 MW AC),
- VNM Paraprake, datë 27.03.2024, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për Personin Juridik “GET Solar Solutions” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “CENTRALI FOTOVOLTAIK VODICA SOLAR PARK 24 MWP”.
- Rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar dokumentacionin në lidhje me mbështetjen financiare për zhvillimin e projektit (neni 9, pika 1.3 germa “b” e Rregullores); miratimin përfundimtar/marrëveshjen për pikën e lidhjes (neni 9, pika 2germa c r Rregullores); dhe nuk ka paraqitur korrespondencën përkatëse me ministrinë në lidhje me saktësimin e kapacitetit të instaluar të centralit (në referencë të zbatimit të detyrimeve për sa përcaktuar në nenin 3.2 të Kontratës nr. 3025 rep., nr. 1478 kol., datë 02.06.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë).
- Për gjithë sa më sipër, edhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore në ERE dhe marrjes së angazhimit nga ana e shoqërisë për të plotësuar/depozituar dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi, nuk rezulton që të jetë depozituar asnjë shkresë apo dokumentacion për të përmbushur sa kërkuar, apo ndonjë arsyetim/argumentim në lidhje me pamundësinë e shoqërisë për të plotësuar këtë dokumentacion brenda afatit dhe paraqitjen e një kërkesë për shtyrje të afatit për të plotësuar sa kërkuar, ndaj për sa parashikuar dhe nga legjislacioni në fuqi, vlerësohet se licencimi i shoqërisë “GET Solar Solution” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të refuzohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të refuzojë licencimin e shoqërisë “GET Solar Solution” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 24 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3164, fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GET Solar Solution” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI